



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 74, datë 12.07.2022

**PËR**  
**MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 30'601'000 (TRIDHJETË MILION**  
**E GJASHTËQIND E NJË MIJË) LEKË PËR FINANCIMIN E SHPENZIMEVE PËR**  
**KARBURANT PËR EFEKT TË RRIJTJES SË ÇMIMIT TË KARBURANTIT**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit Nr.115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, Udhëzimit nr.22, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 158, datë 23.12.2021 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2022, si dhe Projektbuxhetin Afat Mesëm 2022-2024”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**VENDOSI:**

1. Përdorimin e fondit prej 30'601'000 (tridhjetë milion e gjashtëqind e një mijë) lekë për financimin e shpenzimeve për karburant për efekt të rritjes së çmimit të karburantit.
  - 1.a. Ndërmarrjes Shërbimeve Komunale i alokohen 22'601'000 (njëzetedy milion e gjashtëqind e një mijë) lekë për financimin e shpenzimeve për karburant për efekt të rritjes së çmimit të karburantit.

- 1.b. Ndërmarrjes Komunale Plazh i alokohen 8'000'000 (tetë milion) lekë për financimin e shpenzimeve për karburant për efekt të rritjes së çmimit të karburantit.
2. Fondi prej 30'601'000 (tridhjetë milion e gjashtëqind e një mijë) lekë do të merret nga fondet e mbetura nga prokurimi i objekteve të mëposhtëme:

Nr.	Emërtimi projektit	Fondi në lekë
1	Blerje pajisje zyrash	8,060,000
2	Përforcimi i terrenit nga rrëshqitja e dherave në lagjen nr.10 në kodër pranë Currilave nga ana veriore e perëndimore e saj	2,616,004
3	Mobilim në tregun fshatar (faza II)	926,900
4	Mobilim i tregut fshatar	1,149,160
5	Studim projektim Unaza spital Currila	412,752
6	Projekt zbatimi për ndërtimin e shëtitores së plazhit Durrës nga Ura e Dajlanit deri në godinën e Kavalishencës VKB 153, datë 06.12.2021	434,275
7	Blerje mjete për largimin e mbetjeve urbane	8,216,000
8	FV Ndriçimi rruga "Shoqeria Bashkimi", "Aleks Komeni", "Kristaq Boshnjaku", "Paskal Prodani"	2,389,993
9	FV Ndriçimi rruga "Glaukia", (Hysen Myshketa 200 ml)	1,712,692
10	FV Ndriçimi rruga "Enkelejve", "Pena e Artë", deri te kryqezimi rrugës "Dhimiter Kraja"	4,683,224
	<b>TOTALI</b>	<b>30,601,000</b>

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike.


Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

Ani Dyrmishi




**U shpall sot me datë 13.07.2022**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 570/14 prot.

Durrës, më 18.07.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLI I BASHKIAK  
Durrës

KRYETARIT TË BASHKISË  
Durrës

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.74 datë 12.07.2022 Për miratimin e përdorimit të fondit prej 30.601.000 (tridhjetëmiljon e gjashtëqind e një mijë) lekë për financimin e shpenzimeve për karburant për efekt të rritjes së çmimit të karburantit.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që më jep L. gji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës